



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.Nr. 3476/2018

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje të Komunave të Republikës së Kosovës nr.03/L-040, neni 13 dhe neni 58 pika (h), Udhëzimit si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit nxjerrë:

## V E N D I M

PËR RIFORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TË VEÇANTË TË BANIMIT

I. **FORMOHET**, Komisioni për përgaditjen dhe hartimin e programit të veçantë të banimit me këtë përbërje:

- Medina Imishti - Drejtor i DSHMS-së
- Nexhmedin Daci - Drejtor i DUKMM-së
- Shabi Rexhallari - Drejtor për Buxhet dhe Financa
- Kujtim Dernjani - Shef i sektorit të shërbimeve publike dhe
- Amir Bushi - Zyrtar për të drejtat e fëmijëve.

II. Komisioni ka për detyrë që të përgatisë dhe të hartojë programin e veçantë të banimit të komunës së Hanit të Elezit në të cilin do të përfshihen mënyrat, format, mënyrat e financimit, nevojat për banim sipas Ligjit për financimit e programeve të veçanta të banimit duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre, numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa me qira, sigurimin dhe paisjet e truallit me infrastrukturë për ndërtimin e banesave me qira, numrin dhe llojin e banesave që nevojiten të ndërtohen, familjet të cilat do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe kriteret e planifikimit të buxhetit për programet e banimit.

III. Drafti i këtij projekti duhet t'i dorzohet kuvendit të komunës së Hanit të Elezit për miratim.

Vendimi i dërgohet:

- Antarëve të komisionit dhe
- Arkivit të komunës.

Data: 24.04.2018  
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës  
Rufki Suma